

Përshëndetje,

Referuar kërkeses tuaj për informacion:

*Ju lutem na vendosni ne dispozicion shifrat per vitin 2014, 2015, 2016, 2017, 2018,2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023 te personave te cilet kane patur nevojte perkujdesin paliativ ne Republikën e Shqipërisë te cilët kane perfituar nga pagesa ekontributeve nga buxheti i shtetit ipas Ligjit nr. 138/2014*

Sqarojmë se:

Në fushën e kujdesit paliativ vepron Ligji nr. 138, datë 16.10.2014, “Për kujdesin paliativ në Republikën e Shqipërisë”. Fondi lidh kontrate me QSH SOB për financimin e shërbimeve shëndetësore të specializuara nga QSH- SOB në kujdesin shëndetësor parësor të rrethit të Tiranës, për të sëmurët me sëmundje onkologjike nga momentii daljes nga spitali deri në fund të jetës së tyre (kujdes paliativ).

Fondi lidh Kontrate me organizatat jofitimprurese Ryder për njohjen nga Fondi te së drejtës së lëshimit të recetës me rimbursim, nga mjeku i organizatës jofitimprurëse i certifikuar nga Ministria eShëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ofrimin e kujdesit paliativ për të sëmurët me sëmundje onkologjike nga momentii daljes nga spitali e në vazhdim.

Për rajonet që nuk ka ofrues privat të shërbimit paliativ, ndjekja dhe lëshimi i recetes behet nga mjeku i familjes.

Cdo spital ka ngritur dhe ka ne funksion shërbimin paliativ për pacientët (ata te cilet kanë nevojë perkujdes paliativ) me disa shtretër dhe personel shëndetësor që asiston keta pacientë. Barnat që nevojiten për ofrimin e këtij shërbimi, janë barnat e “listës esenciale” të kujdesit paliativ dhe sigurohen nga farmacia e Spitalit.

*Nga statistikat qe Fondi mbledh nuk disponon numër pacientesh.*